


Pasojat e Armeve te Vogla dhe te Lehta (AVL)

NJË NGA GJETJET MË DOMETHËNËSE te këtij raporti, dhe që jep një panoramë të dobishme të një sere pasojash në lidhje me armet në shoqëri shqiptare, ishte që 7.2 per qind e të pyeturve përgjate Studimit të ISO 2005 pohuan që ata apo ndonjë anëtar i familjes së tyre kishin qenë përgjate dymbëdhjete muajve të fundit viktimë të një krimi, dhe pothuajse të gjithë këto krime (të pakten 84.7 per qind, duke mos përfshirë vrasjen, grabitjen e personit dhe krime ‘të tjera’) përfshinin një armë zjarri. Sikurse tregon edhe grafiku i mëposhtëm, grabitjet me armë, të qelluarit aksidentalisht dhe kërcënimet e armatosura, të gjitha së bashku përfaqësojnë keqperdorimin me të zakonshëm të armeve të zjarrit. Nderkohe që 0.6 per qind e të pyeturve raportuan që një anëtar i familjes së tyre kishin qenë qelluar me paramendim, 0.5 per qind mundën të raportojnë një vrasje për qelime hakmarrjeje apo një vrasje tjetër midis anëtarëve të familjes (shumica me e madhe e të cileve, ka shumë mundësi të kenë qenë kryer me armë zjarri).¹¹⁶

A keni qenë ju apo ndonjë anëtar i familjes suaj viktimë e krimeve të mëposhtëme gjatë 12 muajve të fundit?



¹¹⁶ Sipas raporteve në 1998, 87.6 përqind e plagosjeve të qellimshme me pasojë vdekjen në Shqipëri shkaktoheshin nga armët e zjarrit. Krug E G et al, Raport botoror për Dhunën dhe Shëndetin, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2002).

Keto gjetje mund të krahasohen me ato të raportit të vitit 2004 të titulluar *Siguria Njerezore në Shqipëri*, në të cilin raportohet që 2.4 për qind e të pyeturve ishin përfshirë në incidente me armë zjarri, ndërkohë që 34 për qind e të pyeturve pohuan se ata mendonin që një e qelluar aksidentale apo e qellimshme ishte një risk i lartë i sigurisë në Shqipëri.¹¹⁷

Megjithatë sasinë dhe besueshmërinë e kufizuar të të dhënave në dispozicion mbi pasojat fizike dhe mendore të armëve në Shqipëri, shifrat me të fundit tregojnë që Shqipëria qëndron me lartësi mesatarja e Evropës Lindore e Qendrore. Grabitja me armë apo banditizmi të cilat ishin tipike pas turbullirave të 1997 janë rreziqe në pakesim por ende serioze, e ndërkohë që është e vështirë të vlerësohet implikimet e shifrave, krimi i deklaruar është ende në rritje. Në mënyrë të ngjashme, raporti i vetvrasjeve të kryera me armë zjarri në Shqipëri është konsiderueshëm më i lartë sesa mesataret globale të matura në vitin 1998. Ky fakt sugjeron (por nuk provon) impaktin negativ të aksesit ndaj armëve, vecanërisht kur konflikti mbi pronat, xhelozia, alkolizmi dhe depresioni gjenerojnë një rrezik për dhunë apo vetvrasje. Një pasojë e tillë sugjerohet gjithashtu edhe nga analiza e informacionit cilësor në raportet e mediave shqiptare mbi incidentet me armë zjarri nga viti 2002–2005. Ka pak monitorim të besueshëm të dhunës familjare, por informacionet në dispozicion sugjerojnë që kjo lloj dhunë mund të jetë e shpërndarë në mënyrë alarmante, dhe përfshin përdorimin e armëve të vogla e të lehta mbi baze të rregullt. Një mbledhje me e mirë informacioni në lidhje me keto çështje do të ndihmonte në qartësimin e veprimeve me të efektshme në keto fusha.

Gjithashtu domethënëse është treguesi i qartë nga informacioni i siguruar nga dy spitale që shtrimet si rezultat i plagosjes me armë zjarri janë në një zbritje të qëndrueshme, gjë që mund të reflektojë suksesin e mbledhjes së armëve që prej 1997, e që konfirmon nënien e aksesit ndaj tyre. Në mënyrë të ngjashme, shifrat e Ministrisë së Brendshme, në lidhje me pergjakjet me armë zjarri dhe vrasjet për shkak të gjakmarrjes tregojnë gjithashtu një rënie të qëndrueshme. Për më tepër, intervistat në fokus grupet e zhvilluara për këtë raport tregojnë një ndjenje që 'qytetaret e mirë' janë, nga dhe me se shumti, mjaftueshëm të sigurt nga krimet e dhunshme. Duket kështu që niveli i krimeve të dhunshme po bie ndjeshëm në Shqipëri, dhe nuk përben një shqetësim të perdritshëm të familjes shqiptare. Një pikepamje, mbi rendesinë dhe impaktin e posedimit të armëve në Shqipëri bashkëkohore u ofrua nga një i intervistuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, i cili nënvizoi se nëse do të rendisnim rreziqet për sigurinë njerezore në Shqipëri, armët do të vendoseshin poshtë të gjithë të tjerave – si ndotja që mund të kategorizohet si konstante por e një niveli të ulët kercënimi.¹¹⁸ Megjithatë, me të pakten 6.1 për qind të familjeve, që pohojnë në studimin e zhvilluar se kanë patur një eksperiencë krimi me armë zjarri në dymbëdhjetë muajt e fundit, mbetet e qartë se progresi i metejshëm për reduktimin e mundësive të të paturit, dhe keqpërdorimin e armëve është i nevojshëm, në varg me me të tjera masa që do të rrisnin sigurinë publike dhe besimin, dhe vazhdojnë të ketë potencial për forcimin e rënies së nivelit të këtyre krimeve të dhunshme.

2.1 Fatkeqesite nga armët e zjarrit

Për fat të keq perderisa nuk ka një sistem që të rregjistrojë dhe monitorojë, ç'raport i gjithë vrasjeve kryhen me armë zjarri, statistikën me të fundit të detajuar kombëtare për fatkeqesitë nga armët e zjarrit, që ekipi i studimit munda të sigurojë ishin ato të 1998, të cilat ishin përdorur edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për *Raportin Botëror mbi Dhunën dhe Shëndetin* (2002).¹¹⁹ Sipas këtyre shifrave 741 nga 846 demtime

¹¹⁷ Instituti i Studimeve Bashkëkohore, dhe Qendra për Studime Rurale, *Siguria Njerezore në Shqipëri*, (Pergatitur për Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Nentor 2003), fq. 42.

¹¹⁸ Interviste me zyrtar të Ministrisë së Jashtme, 24 Prill 2005.


¹¹⁹ Krug E G et al, *Raport Botëror mbi Dhunën dhe Shëndetin*, (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2002).

te qellimshme qe paten si pasoje vdekjen, vrasjet dhe vetvrasjet perfshine nje arme zjarri.¹²⁰ Me fjale te tjera, 87.6 perqind e rasteve te vrasjeve pa paramendim, vrasjeve me paramendim dhe vetvrasjeve perfshinin nje arme zjarri. Thene ndryshe, ishin gjithsej 22.1 fatkeqesi nga arme zjarri per 100,000 persona. Nga keto 741 raste, 591 ishin raportuar si vrasje, 98 si vetvrasje, 50 si te paqellimshme dhe 2 te papercaktuara.

2.1.1 Vrasjet me arme zjarri

Nga 660 vrasjet e raportuara ne raportin e OBSH, 89.5 perqind e tyre ishin kryer me arme zjarri. Megjithate, ndoshta per shkak te mekanizmave te raportimit, OBSH pohon 87 vrasje me shume se sa shifrat e Ministrise se Rendit Publik te asaj kohe, ne 1998 (sikunder tregohet ne grafikun e meposhtem).

Vrasjet e raportuara që nga viti 1997 (Burimi: Ministria e Rendit Publik)



Megjithese ka patur nje renie te vazhdueshme te vrasjeve qe prej 1997, ne mungese te statistikave treguese, ekipi studimor eshte i paafte te raportoje nese perqindja e vrasjeve te kryera eshte rritur apo ulur nga niveli prej 89.5 perqind ne 1998. Por sipas nje raporti te Policise se Tiranës, ne 2004 njezet vrasje ishin kryer brenda qytetit duke perdorur arme zjarri, sikurse nje grabitje me arme e cila perfundoi ne nje tragjedi.¹²¹ Ne vijim ka patur edhe 93 raste te tjera te raportuara si tentative per vrasje, 22 plagosje, dhe 339 krime te tjera me persona ndaj te cileve ishte perdorur nje arme zjarri. Ky raport gjithashtu nenvizon nje rritje te vjedhjeve dhe vetvrasjeve duke perdorur hanxhare, thika dhe ‘arme te ftohta’.

Kryebashkiaku i Fierit, Baftjar Zeqo, informoi ekipin studimor se shumica e vrasjeve ne Fier ishin kryer me arme zjarri.¹²² Ai besonte se keto vrasje ishin kryer per hakmarrje, dhe nga anetare te grupeve te krimit te organizuar. Sipas Robert Metaj, Drejtor i Kirurgjise ne Spitalin e Fierit, numri i shtrimeve te personave te plagosur me arme zjarri ishte rriyur pergjate stines se veres, periudhe kjo – thekson ai – e njohur per kthimin e emigrantëve shqiptare ne Fier.¹²³ Sipas mendimit te tij rritja e ketij numri eshte rezultat i hakmarrjeve ose vrasjeve per ‘biznese kriminale’. Ai shton gjithashtu se eshte shtuar kohet e fundit dhe numri i femrave te vrara me arme zjarri, dhe atyre te raportuara si te vetvrara. Ne te njejten kohe, numri i plagosjeve te shkaktuara permes festimeve me arme gjate ceremonive dasmore dhe festave te tjera familjare duket se ka rene. Ne pergjithesi, vrasjet me arme zjarri jane te renditura te dytat ne demet njerezore pas vdekjeve per shkak te aksidenteve rrugore ne Fier. Ne Berat u informuam qe nga tri vrasjet te ndodhura gjate gjashte muajve te pare te 2005, njera prej tyre ishte kryer me arme zjarri, ne perputhje me tendencat e fundit te vrasjeve ne rajonin perreth Beratit, nga te cilat nje e treta ishin kryer me arme zjarri.¹²⁴ Megjithate ne Gjirokastrë

¹²⁰ Ibid, p. 322.

¹²¹ Burimi: ‘Sondazh mbi mbledhjen dhe dorezimin e armeve, municioneve dhe materialeve te tjera ushtarake pergjate periudhes 1997–2004’, Drejtoria e Policise Tirane, 2 Mars 2005.

¹²² Interviste me nepunes te pushtetit vendor, 12 Maj 2005.

¹²³ Interviste, Metaj, 15 Maj 2005.

¹²⁴ Interviste, zyrtar i spitalit, 29 Korrik 2005.


armet te parregjistruara, mendoheshin se jane perdorur vetem rreth 10 perqind te plagosjeve dhe fatkeqesive askidentale apo te qellimshme.¹²⁵

2.1.2 Vetvrasjet me arme zjarri

Sipas raportit te OBSH-se *Raport Boteror mbi Dhunen dhe Shendetin* (2002), ne nje nivel 2.9 ne 100,000 vete, kuota e vetvrasjeve te kryera me arme zjarri ne Shqiperi ishte me e ulet se niveli ne Ameriken Veriore, por me i larte se zona te tjera te botes, sipas te dhenave te marra gjate periudhes 1997–1999, sikurse tabela e meposhtme tregon.¹²⁶

Shkalla e vetëvrasjeve me armë zjarri për çdo 100.000 banorë

(Burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2002)



Sipas raportit te OBSH-se, ne 1998, gati njezet perqind e vrasjeve te qellimshme ishin vetvrasje, nderkohe qe gati trembedhjete perqind e te gjitha fatkeqesive me arme zjarri ishin raste vetvrasjesh. Ne nivel te pergjithshem, kuota e Shqiperise eshte 6.5 ne 100.000 vete ne 1998¹²⁷, nen mesataren Evropiane (13.6 per meshkujt dhe 4.3 per femrat 1999–2001).¹²⁸ Tabela e meposhtme tregon shifrat e OBSH-se per numrin e pergjithshem te vrasjeve ne 1998 sipas gjinise dhe grupmoshes, dhe deshmon se 98 nga nje total prej 165 vrasjesh ishin te kryera me arme zjarri.

Tabela 1: Vetvrasjet e kryera ne Shqiperi ne 1998¹²⁹

	Femra	Meshkuj	Totali
Vetvrasjet	61	104	165
Vetvrasjet ne moshen 5–14 vjec	1	2	3
Vetvrasjet ne moshen 15–29 vjec	42	46	88
Vetvrasjet ne moshen 30–44 vjec	9	28	37
Vetvrasjet ne moshen 45–59 vjec	4	18	22
Vetvrasjet ne moshen mbi 60 vjec	4	10	14
Vetvrasjet për një popullatë 100.000	3.6	7.1	6.5
Vetvrasjet e kryera me arme zjarri	–	–	98

Me permiresimin e kontrollit epidemologjik, me me shume te dhena te sakta te mbledhura pergjate viteve do te behet e mundur nje analize me e besueshme e tendencave te pergjithshme. Ne mungese te ketij kontrolli, ekipi studimor ishte i paafte te gjeneroje nje shifer te perafert te vetvrasjeve te kryera ne Shqiperi me arme zjarri qe prej 1998. Megjithate shifrat e OBSH-se per vitin 1998, tregojne se me teper se 59 perqind e vetvrasjeve ne Shqiperi jane kryer me arme zjarri. Kjo qendron shume me lart se mesatarja boterore 19.5 perqind e vendeve ku te dhenat jane te disponueshme

¹²⁵ Interviste, zyrtar i spitalit, 6 August 2005.

¹²⁶ Op cit Krug et al. p.322.

¹²⁷ Po aty

¹²⁸ Op cit Taylor, Phillips and Bogoz AVALjevic, p. 30.

¹²⁹ Op cit Krug et al, pp. 314 and 315.

per vitin 2002 ne raportin e OBSH-se,¹³⁰ dhe sugjeron hipotezen qe aksesin ndaj armeve te zjarrit eshte shume i lehte per personat ne rrezik vetvrasje. Kjo duket se ka qene situata aktuale perderisa shifrat qe i referohen vitit pas grabitjes se me shume se nje milion arme te vogla e te lehta. Efekti i grumbullimeve pasuese te armeve mbi nivelin e vetvrasjeve, nuk mund te percaktohet pa nje informacion rutine dhe mekanizmat e mbledhjes dhe raportimit te ketij informacioni nga institucionet qe sigurojne kujdesin shendetesor.

Shifrat nga permbledhjet analitike te medias te perdorura ne kete Studim (perfshire ketu me poshte ne sesionin 2.5), tregojne se ne Gazeten *Shekulli* per periudhen 2002–15 Maj 2005 jane shfaqur nje mesatare prej 20.2 rastesh te raportuara ne vit te vrasjeve me arme zjarri.¹³¹


2.1.3 Vdekjet aksidentale te lidhura me armet e zjarrit

Sikurse u tha me lart, 2.3 perqind e te pyeturve raportojne qe ata apo nje anetar i familjes se tyre, eshte qelluar aksidentalisht ne dymbedhete muajt e shkuar, nderkohe qe OBSH raporton ne 2002 se ne Shqiperi ne 1998 ka patur 50 vrasje te paqellimshme te shkaktuara nga armet e zjarrit (nje vlere 1.5 per nje popullate prej 10.000). Shifrat per te plagosjet aksidentale nga spitali i Fierit te cilat tregohen ne sesionin 2.2 sugjerojne nje renie te lehte ne numra per periudhen 2000–2004, por saktesia e klasifikimit si 'aksidentale' eshte zbatuar korrektesisht ne rastet e raportuara. Mungesa e historive mbi aksidentet e lidhura me armet e zjarrit nga gjetjet e hetimeve mediatike sugjerojne qe rreziku i aksidenteve te shkaktuara nga armet e zjarrit eshte i nen-raportuar sidomos sepse kuota prej 50 vrasjesh ne vit per kete shkak ka mbetur konstante qe prej vitit 1998 kur eshte kryer sondazhi i fundit.

2.2 Plagosjet me arme zjarri


Megjithese nuk ishte e mundur te perftoheshin statistika kombetare autoritare mbi plagosjet dhe vrasje me arme zjarri dy spitale individuale, Spitali Ushtarak ne Tirane, dhe Spitali i Fierit, na siguruan te dhena te cilat japin nje pershtypje te besueshme mbi nivelin e pergjithshem te plagosjeve. Tendenca e plagosjeve te regjistruara ne total nga dy spitalet e siperpermendura ne vitet e fundit (ne rastin e Spitalit Ushtarak per 1997–Shtator 2005, dhe ne rastin e Spitalit te Fierit per 2000–Mars 2005) tregohet ne tabelen e meposhtme si nje renie graduale.

Plagosje me armë zjarri të regjistruara në Spitalin Ushtarak 1997–Shtator 2005



¹³⁰ Kjo eshte nje perqindje e totalit te mbledhur te te gjithe vetvrasjeve te kryera me arme zjarri ne vendet ku vetvrasjet me arme zjarri jane regjistruar, me shume se sa mesatare e kuotave te vendeve te listuara, te llogaritura nga te dhenat ne op cit Krug et al, pp. 314–323.

¹³¹ Kjo mesatare merr ne considerate vlerat mujore ne 4.5 muajt e pare te vitit 2005.

Plagosje me armë zjarri të regjistruara në Spitalin e Fierit 2000–Mars 2005

Statistikat e spitalit ushtarak Tirane përfshijnë pjesën më të madhe të rasteve të plagosjes me armë zjarri nga Shqipëria e Mesme, por vetëm rastet më të rënda të plagosjeve me armë zjarri të Shqipërisë së Jugut dhe asaj të Veriut, prandaj kategorizimi sipas rajoneve nuk duhet marrë si tregues i shpërndarjes gjeografike të këtyre rasteve.

Tabela 2: Plagosjet me armë zjarri të regjistruara nga Spitali Ushtarak 1997–Shtator 2005¹³²

Muaji	Shqipëria Jugore		Shqipëria e Mesme		Shqipëria Jugore	
	Plagosje jovdekje-prurese	Plagosje vdekje-prurese	Plagosje jovdekje-prurese	Plagosje vdekje-prurese	Plagosje jovdekje-prurese	Plagosje vdekje-prurese
1997						
Janar			4		1	
Shkurt			9		2	
Mars	14		110		23	1
Prill	32	2	64	6	38	2
Maj	28	2	59	8	24	1
Qershor	27	1	61	5	27	7
Korrik	40		58	1	29	3
Gusht	21	2	37	1	25	1
Shtator	13	3	30	4	28	2
Tetor	1	1	31	2	21	
Nentor	3	2	30	3	5	1
Dhjetor	2	2	7		6	
Totali	973					

¹³² Hyrjet në Spitalin Ushtarak klasifikohen në pesë kategori: trauma, ortopedi, radiologji, semundjet e brendshme dhe semundjet infektive. Rregjstri i hyrjeve shënon çdo pranim të ri me një numër të cili tregon kategorinë e trajtimit dhe rregjistrin informacionin e mëposhtëm: emrin e pacientit dhe adresën; kategorinë e hyrjes në spital dhe diagnozën e plote; datën e hyrjes së pacientit dhe daljen e tij. Pjesa më e madhe e plagosjeve me armë zjarri klasifikohen si trauma, ose ndonjëherë edhe si raste ortopedie sepse kanë të bëjnë me frakturë. Mëqenëse numri i klasifikimit tregon vetëm nëse plagosja ka qenë trauma apo frakturë ortopedike, e vetmja mënyrë për të marrë vesh nëse është përdorur një armë zjarri është të gjendet informacioni në lidhje me diagnozën e plote të rregjistrimit të individit.

Muaji	Shqiperia Jugore		Shqiperia e Mesme		Shqiperia Jugore	
	Plagosje jovdekje- prurese	Plagosje vdekje- prurese	Plagosje jovdekje- prurese	Plagosje vdekje- prurese	Plagosje jovdekje- prurese	Plagosje vdekje- prurese
1999						
Janar	8		19		9	
Shkurt	6		16		8	
Mars	6		10		9	1
Prill	7		17	3	14	
Maj	1		11		4	
Qershor	4		13	1	9	1
Korrik	6		10	1	8	
Gusht	2		18		6	
Shtator	5	1	10		5	2
Tetor	2		9	5	4	
Nentor	1		11	1	5	
Dhjetor			3	1	1	1
Totali	295					
2001						
Janar	5		7	2	8	
Shkurt	4		5		5	
Mars			3	1	6	
Prill	2		5		4	
Maj			5		3	
Qershor	1		3		6	
Korrik	2		3		6	
Gusht	2		5	1	6	
Shtator	3		10		2	
Tetor	3		5	1	5	2
Nentor	2		3	1	3	1
Dhjetor	1	1	5	1		1
Totali	150					
2003						
Janar	1		4	1	5	
Shkurt			3		3	
Mars	2		6		4	
Prill	3		5		1	
Maj	1		2		3	
Qershor	1		8	1	4	
Korrik	1		7		7	
Gusht	2		6	2	3	
Shtator	2		3		5	
Tetor	1		4		2	
Nentor	1		4		2	
Dhjetor	2		2			
Totali	114					

2005

Janar		2			1
Shkurt		3		1	1
Mars		1	1		
Prill				1	
Maj	1	3	1	1	
Qershor	1	3		2	
Korrik				4	
Gusht	1	1		2	
Shtator		3			
Totali	34				
Totali (te gjitha vitet)	274	18	776	55	415
					29
					1567

Statistikat e spitalit të Fierit, regjistrojnë jo vetëm numrin e përgjithshëm të incidenteve me armë zjarri, të pranuar në Spitalin e Fierit për periudhën 2000–Mars 2005, por reflektojnë gjithashtu edhe të dhënat gjinore, moshore dhe statistikën urbane/rurale të individëve të plagosur.¹³³


Tabela 3: Rastet me armë zjarri të pranuar në Spitalin e Fierit 2000–Mars 2005

Year	2000	2001	2002	2003	2004	2005 (Q1)
Meshkuj	43	29	13	17	23	8
Femra	8	4	6	6	5	0
Urban	20	10	7	5	11	3
Rural	31	23	12	18	17	5
0–14 vjec	1	2	2	1	4	1
15–24 vjec	6	8	8	12	4	0
25–34 vjec	14	7	2	6	5	5
35–44 vjec	11	12	3	3	2	1
45–54 vjec	11	4	1	0	2	0
Mbi 55 vjec	7	0	3	1	10	1
Mosha e paditur	1	0	0	0	1	0
'Gjuajtje aksidentale'	39	25	19	21	24	6
'Gjuajtje aksidentale' nga meshkuj	34	21	13	15	20	6
Gjuajtje të qellimshme	12	8	0	2	4	2
Gjuajtje të qellimshme nga meshkuj	9	8	0	0	3	2
Totali i incidenteve me armë zjarri	51	33	19	23	28	8

Megjithatë nuk mund të argumentohet që kjo tabelë mund të përdoret si një përfaqësim i saktë i plagosjeve apo vrasjeve me armë zjarri në Shqipëri, ofron një ide mbi situatën në Shqipëri në përgjithësi. Kështu, pavarësisht nga shqetësimi për përdorimin e armëve në dhunën shtëpiake, e nënvizuar në sesionin 2.3 (raste që mund të mos i jënë drejtuar asnjëherë spitalit), këto shifra mund të sugjerojnë që me shumë meshkuj sesa femra janë plagosur nga armët e zjarrit në Shqipëri, sikurse studimi mbi familjen tregoi që janë meshkujt që me shumë sesa femrat posedojnë një armë në Shqipëri. Gjithashtu i dukshëm është këtu, fakti që incidentet me armë zjarri kanë ndodhur me shumë në zonat rurale sesa në ato urbane. Ky fakt përputhet mirë me perceptimin e fortë që armët e zjarrit janë më të përhapura në zonat rurale sesa në ato urbane (e raportuar në sesionin 3.5.4, 'Perceptime të posedimit të AVL nga civilët), dhe ndoshta dobeson pershtypjen që posedimi i armëve në zonat rurale është kryesisht i legjitimuar, me tepër praktik sesa për përdorim kriminal. Shpërndarja e pranimeve sipas grupmoshave për pesë vitet dhe tre muajt e mbuluar në tabelën e mëposhtme

tregon se si shihet zakonisht që viktimat e dhunës së armatosur, në këto të dhëna kryesisht përfshijnë moshën 15–34 vjeç, që përben edhe 47.5 përqind të të gjitha rasteve.


Shpërndarja sipas grupmoshës i rasteve me armë zjarri të shtruar në Spitalin e Fierit 2000–Mars 2005



2.3 Dhuna në familje

Kur u pyetën nëse armët e zjarrit i përmirësojnë apo i përkeqësojnë marrëdhëniet brenda familjes, 84.9 përqind e pjesëmarrësve në studimin e brendshëm të kryer për këtë raport, u përgjigjën që ato i përkeqësojnë pak (25.9 përqind) apo i përkeqësojnë ato (59.0 përqind). Më shumë gra (62 përqind), se burra u shprehën për të dytën.

Mendoni se armët e zjarrit përmirësojnë apo përkeqësojnë marrëdhëniet brenda familjes?



Përpyekja e vetme për të vlerësuar dominimin e dhunës në familje nga ana sasiore në Shqipëri është shifra që jepet nga një studim i vitit 1996 mbi dhunën kundër grave sipas së cilit raportohej që pothuajse 40% e pjesëmarrësve i nënshtroheshin rregullisht dhunës fizike.¹³⁴ Sipas raportit të paraqitur nga Eglantina Gjermani dhe Majlinda Bregu të Qendrës së Aleancës Gjimore për Zhvillim, statistikat zyrtare për dhunën në familje nuk janë të besueshme dhe nuk japin një panoramë të vërtetë të shkallës së problemit.¹³⁵ Raporti e studion këtë fenomen duke eksploruar trajtimin që i bëhet dhunës në familje nga media shqiptare, dhe arrin në përfundimin që gjatë viteve të fundit kemi patur një rritje të krimit në familje. Aty gjithashtu thuhet që vëmendja e medias ka prirje të përqendrohet më shumë në aspektet sensacionale të dhunës në familje, dhe në mënyrë tipike raportet janë të pasakta, u mungon cilësia analitike si edhe i anashkalojnë pyetjet rreth përgjegjësisë shoqërore. Më poshtë jepet një shembull i titujve të gazetave mbi viktimat e dhunës në familje në vitin 2001:

“Krimi në familje: Vëllai vret motrën”, (Shekulli, 27 mars 2001)

“Djali sulmon prindërit me një granatë dore- nëna vdes”, (Shekulli, 11 janar 2001)

“Babai qëllon me armë vajzën e tij të vetme”, (Shekulli, 10 mars 2001.)

¹³⁴ Shoqata e Grave Shqiptare, Dhuna Kundër Grave, (Raporti Refleksione, 1996), i cituar në A. Babani, Dhuna në Familje Kundër Grave në Shqipëri, (UNICEF 2003), fq. 15.

¹³⁵ Përfaqësueset e OJF-së E. Gjermani dhe M. Bregu, Monitorimi I medias në lidhje me Dhunën në Familje 2001&2002, (Qendra e Grave, 2003).

“Ekzekuton gruan dhe vjehrrën, pastaj vetëvritet me plumbin e fundit që i ka ngelur”, (Republika, 17 shkurt 2001).

“Dashuria vdes: Burri xheloz vret të dashurën para se të vrasë veten” (Republika, 22 qershor 2001)

“Terror, masakër: Burri vret gruan dhe djalin me një pushkë automatike”, (Republika, 7 tetor 2001)

Në raportin e Qendrës së Grave për median në vitin 2001, gjashtë gazetatat kryesore që u vëzhguan kishin 207 artikuj mbi dhunën në familje, nga të cilat 48 flisnin për vrasjet brenda familjes, pesë për tentativa vrasjesh dhe tre për vetëvrasjet.¹³⁶ Nga instrumentet e përdorura në krimet e abuzimit në familje, 62 përqind e rasteve përfshinte përdorimin e AVL-ve (36 përqind pushkë automatike, 13 përqind pistoleta dhe 13 përqind bomba dhe granata). Kjo e krahasuar vetëm me 13 përqind të rasteve të përdorimit të thikave.¹³⁷ Përsëri, sensacioni i krijuar nga media nënkupton që të dhënat e këtyre studimeve nuk mund të konsiderohen si përfaqësuese të situatës së përgjithshme në popullsinë e gjerë. Sidoqoftë, duke patur parasysh vdekshmërinë e lartë të shkaktuar nga plagosjet me armë zjarri në krahasim me ato të shkaktuara nga mjete të tjera, aksesi ndaj armëve të zjarrit mund ta rrisë rrezikun e palgosjeve të rënda të grave pavarësisht nga mbizotërimi aktual që ka dhuna në familje në të gjithë shoqërinë shqiptare. Shumica e rasteve të zbuluara rreth abuzimit fizik kanë xhelozinë si shkak të shprehur, (27 përqind), grindjet (24 përqind), alkoolin (10 përqind) dhe problemet e shëndetit mendor (10 përqind) gjithashtu të cituara.¹³⁸

Analiza e bërë nga Qendra e Grave dhe Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim gjithashtu sugjeron që as zbatimi i ligjit dhe organet e drejtësisë, dhe as media nuk e marrin seriozisht dhunën në familje. Ajo në përgjithësi shihet si një gjë “private” mes një burri dhe gruas së tij (d.m.th. gruaja konsiderohet si “pronë” e burrit), dhe interesi i medias që rritet nga hollësitë e frikshme të krimit.

Sipas OJQ-së Ndalonit Dhunën Kundër Grave, megjithëse Neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë garanton barazinë para ligjit, nuk ekzistojnë ligje të veçanta mbi dhunën në familje.¹³⁹ Një dhunë e tillë mund të ndiqet penalisht si kërcënim sipas Kodit të Procedurës Penale, I cili parashikon një sërë gjobash dhe dënimesh me burgim në bazë të rëndësisë të krimit.¹⁴⁰ Plagosja me dashje jo e rëndë, përdhunimi dhe ngacmimi seksual mund të ndiqen penalisht vetëm kur viktima depoziton një padi.¹⁴¹

2.4 Krimet e raportuara dhe normat e viktimizimit

Sipas të dhënave kryesore të Studimit Ndërkombëtar mbi Viktimizimit (ICVS) të vitit 2000, Tirana është mbi mesataren e kryeqyteteve të Europës Qendrore dhe Lindore si përsa i përket numrit të krimeve për 100 banorë (shkalla e veprimit), ashtu edhe në lidhje me përqindjen e pjesëmarrësve të cilët ishin viktima të krimit (përhapja), në vitin para kryerjes së studimit.¹⁴² Normat mesatare të shkallës së veprimit dhe të përhapjes për kryeqytetet e Europës Qendrore dhe Lindore ishin përkatësisht 52 dhe 27 përqind, për Tiranën ato ishin 56 dhe 32 përqind. Është mjaft interesant fakti që, 44 përqind e pjesëmarrësve me banim në Tiranë, e vlerësonin si pozitive punën e policisë në vitin 2000, ndërsa 48 përqind e tyre e vlerësonin atë si negative. Megjithëse kjo i afrohej shumë mesatareve të kryeqyteteve të Europës Qendrore dhe Lindore,

¹³⁶ Po aty, fq.19.

¹³⁷ Po aty, fq.22.

¹³⁸ Po aty, fq.23.

¹³⁹ Ndalonit Dhunën Kundër Grave, “Shqipëria” <http://www.stopvaw.org/Albania.html>, I hapur më 9 nëntor 2005.

¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ Po aty.

¹⁴² Llojet e krimeve që trajtohen nga ICVS janë: vjedhja e makinave, vjedhja nga makinat, vandalizmi ndaj makinave, vjedhja e motocikletave, vjedhja e biçikletave, vjedhje me thyerje, vjedhje me thyerje në tentativë, grabitja, vjedhje e pasurisë vetjake, krimet seksuale (vetëm ndaj grave) kërcënimi dhe kërcënimi për sulm.. Burimi: A Alvazzi del Frate, J.N. Van Kesteren, Viktimizimi në Europën Urbane. Të dhënat kryesore të nxjerra nga Studimi Ndërkombëtar mbi Viktimizimin i vitit 2000 (UNICRI, 2004), <http://www.unicri.it/wwwd/analysis/icvs/pdf_files/CriminalVictimisationUrbanEurope.pdf>

(47përqind negative dhe 44 përqind pozitive), ndryshimi i përqindjes ndërmjet atyre që e vlerësonin policinë në mënyrë pozitive dhe atyre që e vlerësonin atë negativisht ishte më i vogli në të gjitha kryeqytetet Europiane të përfshira në studim. Studimi gjithashtu theksoi që 60 përqind e pjesëmarrësve në Tiranë ndjeheshin të sigurtë kur ecnin vetëm natën në lagjen e tyre “ në krahasim me 40 përqind prej tyre të cilët nuk ndjeheshin të sigurtë, duke nënkuptuar që Tirana klasifikohet si më e sigurtë sesa mesatarja e kryeqyteteve të Europës Qendrore dhe Lindore.¹⁴³

Të intervistuarit e fokus grupit nga Tirana gjithashtu shprehën mendime pozitive në lidhje me nivelin e sigurisë personale të perceptuar nga ta- edhe pse disa prej të intervistuarve ishin pak të shqetësuar për të dalë jashtë natën. Sipas fokus grupit dhe të intervistuarve të tjerë, Tirana konsiderohet si një nga vendet më të sigurta për të jetuar në Shqipëri. Për shembull, një i intervistuar i fokus grupit nga Shkodra e klasifikoi sigurinë publike në kryeqytet si më të mirë se ajo në Shkodër kur ai tha që:

Sidoqoftë ka një ndryshim mes Tiranës dhe Shkodrës. Ka njerëz që ndjehen më të sigurtë në Tiranë. Unë njoh disa biznesmenë të cilët kanë frikë të zhvillojnë biznesin e tyre në Shkodër, kështu që kanë shkuar në Tiranë.

Fokus Grupi, Shkodër, Mashkull, gusht 2005.

Shenja të tjera frike në qytetet e Shqipërisë janë raportuar në lidhje me kohën gjatë së cilës njerëzit dalin jashtë natën. Për shembull, një përfaqësues i dhomës së tregtisë së Beratit, tha që pas orës 9 të mbrëmjes¹⁴⁴ nuk mund të shohësh asnjë njeri në restorantet e Beratit, dhe një mendim i tillë u dha edhe në Shkodër:

Kam vënë re se njerëzit [duket] sikur mendojnë që shteti i vërtetë nuk ekziston. Ndoshta ju nuk jeni përdhunuar apo grabitur në mes të rruges, por ju keni frikë se kjo mund të ndodhë, sepse ju mendoni që shteti nuk ka asnjë autoritet mbi njerëzit. Zakonisht në Shkodër, veçanërisht nga tetori deri në shkurt, dua të them gjatë dimrit, ndodh shumë rrallë që njerëzit të dalin natën për tu argëtuar apo thjesht për të bërë një shëtitje pas orës 8 të mbrëmjes. Dy vjet më parë njerëzit nuk dilnin as pas orës 7, tani nuk dalin pas orës 8. dhe është një rast i veçantë të shohësh njerëz në rrugë pas orës 9. Përse? Sepse ata akoma kanë frikë, ngaqë është natë jashtë, kështu që duhet të rrinë në shtëpi. Dua të them se edhe kur nuk ekziston një frikë konkrete, është thjesht ajo ndjenja e përgjithshme që shteti nuk ka mundësi të të mbrojë, kështu që është e rrezikshme të dalësh natën.

Fokus Grupi, Shkodër, Mashkull, gusht 2005.


Sipas sondazhit të ISO të bërë në vitin 2005, 19.9 përqind e pjesëmarrësve, kishin frikë se mos ata ose ndojnë anëtar i familjes së tyre mund të bëhej viktimë e ndonjë krimi në të ardhmen. Sipas raportit të përgatitur në vitin 2004 nga Qendra e Studimeve Rurale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, vetëm 9 përqind e pjesëmarrësve mendonin që zona e tyre kishte një shkallë të ulët apo shumë të ulët sigurie. Shumica e të intervistuarve shpjegonin që shkalla e sigurisë po rritej për shkak të: uljes së kriminalitetit, dhe në veçanti atij të armatosur, pakësimit të gjakmarrjeve, perspektivës ekonomike më të mirë; si edhe fakti që ata mendonin se shumica e kriminelëve të “rrezikshëm” ishin larguar nga Shqipëria.¹⁴⁵ Megjithëse, raporti i vitit 2004 arrinte në përfundimin që shkalla e supozuar e kriminalitetit publik ishte më e ulët se ajo e vitit 2002, ata shpreheshin që ende ekzistonte mendimi që publiku besonte që niveli i kriminalitetit në zonat urbane ishte më i lartë në krahasim me atë të zonave rurale.¹⁴⁶ Ishte mjaft interesant fakti që, ndërkohë që publiku besonte që gjendja e kriminalitetit në Shqipëri ishte duke u përmirësuar, numri i krimeve të raportuara ishte në rritje.

¹⁴³ Përgjigjet mesatare për kryeqytetet e Europës Qendrore dhe Lindore ishin 51 përqind e pjesëmarrësve të cilët theksonin që ata ishin të pasigurtë dhe 49 përqind e tyre që shpreheshin se ishin të sigurtë. Po aty.

¹⁴⁴ Intervistë, Dhoma e Tregtisë e Beratit, 30 korrik 2005.

¹⁴⁵ Op cit, Qendra e Studimeve Rurale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, fq.23.

¹⁴⁶ Po aty, fq. 27.

Krime të regjistruara në Shqipëri 1997–2004 (Burimi: Ministria e Rendit Publik)

Sipas statistikave zyrtare mbi krimet, përqindja e krimeve totale të regjistruara të kryera kundër personit po l kthehet niveleve të krahasueshme me periudhën e para vitit 1997.

Tabela 4: Krimet kundër personit sipas viteve (1992–2004)

Viti	Krimet kundër personit	Totali i krimeve të regjistruara	% e krimeve totale kundër personit
1992	1,874	11,241	16.6%
1993	2,090	9,412	22.2%
1994	2,007	7,423	27%
1995	1,664	6,370	26.1%
1996	1,486	5,221	28.4%
1997	3,141	6,394	49.1%
1998	1,877	5,954	31.5%
1999	1,909	5,612	34%
2000	1,858	5,199	35.7%
2001	1,631	3,728	38.2%
2002	1,586	4,975	31.9%
2003	1,726	5,816	29.7%
2004	2,019	7,896	25.5%

MB dhe vëzhguesit ndërkombëtarë pajtohen me faktin që rritja e numrit të krimeve të raportuara dhe të atyre kundër personit ka të ngjarë që të jetë më shumë pasojë e përmirësimit në regjistrimin e krimeve të raportuara sesa e një rritjeje në vlerë absolute të veprimtarisë kriminale.¹⁴⁷ Sigurisht, regjistrimi jo i saktë i të dhënave për veprimtaritë kriminale gjatë viteve të shkuara, e bënte më të vështirë arritjen në përfundimin nëse kjo rritje ndodhte për shkak të procedurave të përmirësuara të regjistrimit të krimeve apo të veprimtarisë kriminale në rritje. Rritja e numrit të krimeve të raportuara gjithashtu mund të jetë edhe si pasojë e rritjes së besimit të publikut për raportimin e krimeve në polici. Gjithashtu, ashtu si ndodh në shkallë të ndryshme në të gjitha vendet, shumë viktima të krimeve nuk i raportojnë krimet në polici. Sidoqoftë, niveli i raportimit ose i mosraportimit- të krimeve në polici është në dukje i krahasueshëm me normat e vendeve të tjera Europiane dhe Amerikano-Veriore.¹⁴⁸ Pavarësisht nga kjo, sipas analizës së bërë nga Dennis J Kenney, shqiptarët ende mbeten më të ndjeshëm ndaj krimeve të dhunshme kundër personit sesa njerëzit e vendeve të tjera perëndimore.¹⁴⁹

¹⁴⁷ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 27 prill 2005, op cit MRP, fq.61.

¹⁴⁸ Sipas Kenney, ndërkohë që vrasjet (100 përqind), vjedhja me thyerje e bizneseve(91 përqind) dhe grabitja (81 përqind) klasifikohen të kenë norma të larta të raportimit publik, vjedhjet (41 përqind), ngacmimet seksuale(56 përqind) dhe kërcënimet për sulme(63 përqind) nuk raportohen kaq shpesh në polici. D.J.Kenney *Perceptimet Publike për Policinë në Shqipëri: Studime Mbarëkombëtare të Banorëve dhe Policisë* (Universiteti Shtetëror I Nju Jorkut dhe PNUD SSSR, 2004), fq. 11.

¹⁴⁹ Op cit, Kenney, fq. 11–12.

Megjithëse shumica e pjesëmarrësve të fokus grupit nuk thanë që niveli i sigurisë publike ishte shumë më i lartë se në vitin 1997, ata ende shprehën shqetësim në lidhje me mundësinë që të goditeshin dhe të vriteshin me armë zjarri. Një nga pjesëmarrësit e fokus grupit e lidhi këtë me strategjinë e mbledhjes së armëve, duke kërkuar që të shkohej tek sekuestrimi i armëve dhe jo të mbetej thjesht tek dorëzimi vullnetar me besimin që kjo do të reduktonte pasigurinë duke i bërë qytetarët e zakonshëm të mos e bënin normë të sjelljes normale armëmbajtjen pa leje:

Është mjaft e qartë se këtu mungon siguria. Asnjë prind nuk është i sigurt kur dërgon fëmijët në shkollë, kur kthehen, kur marrin pjesë në veprimtari të ndryshme shkollore. Ekziston mungesa e sigurisë. Pse? Sepse të gjithë zotërojnë një armë-pa leje në shumicën e rasteve. Ne i shohim këta njerëz që kanë armë në jetën e përditshme, e dëgjojmë këtë tek lajmet, filan person u vra, një tjetër vrau veten. Unë mendoj që qeveria duhet të bëjë diçka. ajo duhet të bëjë kontrollë herë pas here, jo duke nxjerrë sekrete, jo duke u thënë njerëzve që në filan orë, në filan ditë, do të bëhet një kontroll për armë. Kështu që i gjithë ky informacion krijon një ndjenjë të përgjithshme të mungesës së sigurisë në familje, shoqëri dhe kudo. E di që është mjaft e vështirë ta mbash sekret një gjë të tillë, njerëzit flasin me njëri-tjetrin, dhe pastaj çdo njeri që ka armë do ta mësojë këtë, dhe do ta fshehtë atë në ndonjë vend. Kështu, që ne gjithmonë do të jetojmë me mungesën e sigurisë dhe do të ndjehemi të pasigurtë- deri ditën kur autoritetet ta marrin seriozisht këtë çështje.

Fokus Grupi, Shkodër, Femër, gusht 2005.

Kjo frikë padyshim që ushqehet nga rregullsia me të cilën ende mund të dëgjosh për incidente me armë zjarri në këtë rajon. Në fokus grupet e ngritura në Fier dhe Shkodër, të paktën një pjesëmarrës ishte në gjendje të kujtonte një incident me armë zjarri në rajonin përkatës.

A mund të kujtoni ndonjë incident me armë që ka ndodhur kohët e fundit?

– Në një fshat, javën që shkoi, një burrë vrau vjehrrën dhe gruan e tij.

FG, Fier, Femër

– Dje, ndodhi një incident në një familje, pati disa të shtëna, por fatmirësisht asnjëri nuk u vra.

FG, Fier, Mashkull

– Dje, një tregtar u vra në treg, ai po shiste atje si gjithmonë, dhe u vra me armë.

FG, Shkodër, Femër

2.4.1 Grabitja me armë dhe kërcënim

Ndër format më të zakonshme të raportuara të përdorimit të armëve të zjarrit në periudhën menjëherë pas vitit 1997 ishin “banditizmi” dhe grabitja me armë.¹⁵⁰ Edhe pse mendohej se këto ishin në rënie, në 2004 pati 134 raste të raportuara të grabitjes me dhunë dhe në 93 prej tyre pati përdorim të armëve të zjarrit. Në fillim të vitit 2005, u raportua që një bandë e maskuar dhe e armatosur, që grabiste makinat dhe furgonat që udhëtonin në rrugët rurale të rrethit të Matit ishin kapur nga policia, falë një sinjalizimi anonim.¹⁵¹ Pesëdhjetë oficerë policie rrethuan bandën e pesë të rinjve nga rrethi i Dibrës në Shqipëri, të cilët dyshoheshin se vidhnin armë nga makinat dhe furgonat që ndalohehin nga ta. Në shtëpinë e njërit prej të ndaluarve, policia gjeti 8 pushkë automatike, 4.000 copë municion, dhe materiale eksplozive. Në një raport të vitit 2005 thuhet gjithashtu që një polic shkodran dyshohej për pjesëmarrje në grabitjet e armatosura në rrugë, pasi në makinën dhe shtëpinë e tij u gjetën objekte dhe armë të vjedhura.¹⁵²

Pati gjithashtu një numër raportesh në fund të vitit 2004 dhe në fillim të 2005 sipas së cilave të rinj pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetëvjeçarë kishin nxjerrë armë dhe

¹⁵⁰ Op cit Lawson and Saltmarsh; op cit Saltmarsh

¹⁵¹ “Grabitës të maskuar dhe të armatosur vjedhin armë nga makinat në rrugët rurale të Matit, Çështjet e Krimin dhe Korrupsionit në Shqipëri, 8–14 janar 2005. Burimi: Shekulli, 12 janar 2005.

¹⁵² “Polici shkodran dyshohet për grabitjet në rrugë”, Çështjet e Krimin dhe Korrupsionit në Shqipëri, 12–18 shkurt 2005. Burimi: Shekulli, 17 shkurt 2005

kërcënuar disa pronarë klubesh nate në Shkodër dhe Tiranë.¹⁵³ Në këto raste, të rinjve ju gjetën revole të paregjistruara. Në fillim të vitit 2005, një person nga Berati u dënua me 2 vjet heqje lirie sepse më 20 djetor të vitit 2004, kishte hyrë në komisariatit e policisë në Berat me një Kallashnikov në dorë dhe kishte kërcënuar të vriste shefin e policisë.¹⁵⁴ Në një episod tjetër, një officer policie jashtë shërbimi, u akuzua gjithashtu për përdorim të armës së tij për të kërcënuar një bashkëfshatar të tijin, konkretisht duke e qëlluar këtë të fundit, sipas një raporti të publikuar në janar të vitit 2005.¹⁵⁵ Këto raste duket sikur mbështesin mendimet e Ali Hajdanit, Kryeinspektorit të Drejtorisë së Policisë së Fierit, i cili argumentoi që vetë fakti që armët janë lehtësisht të disponueshme, do të thotë që ato mund të përdoren me lehtësi për qëllime kërcënimi”.¹⁵⁶

2.4.2 AVL-të në gjakmarrjet, hakmarrjet dhe ndikimi i tyre më gjerë

Gjakmarrja është një hakmarrje e cila rregullohet nga ligji kanunor shqiptar (Kanuni).¹⁵⁷ Kur një anëtar i një familjeje është çnderuar apo vvarë nga një anëtar i një tjetër familjeje, të parët kanë të drejtë të kërkojnë ”kompensim (dëmshpërblim)” nga të dytët në përputhje me interpretimin që i bëhet Kanunit nga Komiteti i Gjakut apo Këshilli i Pleqve. Familja e dëmtuar mund të kërkojë shpazim me gjak (duke vvarë një nga meshkujt e familjes tjetër), ose pas ndërmjetësimit mund të japë një falje me shpirtmadhësi (duke marrë në shkëmbim një pagesë në formë parash apo prone).¹⁵⁸ Ndërkohë që numri i regjistruar i vrasjeve për motive gjakmarrjeje ra deri në 10 në vitin 2004, ai sigurisht që ka patur rritje përsa i përket përqindjes së të gjitha vrasjeve të raportuara në Shqipëri duke filluar nga viti 1991, dhe vazhdon të konsiderohet si motiv shqetësues në të gjithë Shqipërinë.¹⁵⁹ Rëndësia e fenomenit për këte raport qëndron në faktin që Kanuni i referohet në mënyrë të veçantë armëve të zjarrit si mjete për kryerjen e vrasjeve dhe për të marrë hak për to.¹⁶⁰ Edhe pse muk mund të thuhet se gjakmarrjet kryhen në përputhje të plotë me Kanunin, është e qartë që niveli i vrasjeve për motive gjakmarrjeje, e implikon nivelin e dhunës së shkaktuar nga armët e zjarrit në shoqërinë shqiptare.

Në shekullin e njëzetë, Ahmet Zogu dhe Enver Hoxha kërkuan ti jepnin fund zbatimit të Kanunit meqë ata u përpoqën të ndërtojnë një shtet modern shqiptar¹⁶¹. Në përgjithësi, përpjekjet e Hoxhës janë konsideruar si relativisht (në disa raste, si në mënyrë spektakolare) të suksesshme në ndalimin e gjakmarrjes¹⁶²; thuhet që gjatë sundimit 40 vjeçar të Hoxhës u regjistrua vetëm një vrasje për motive gjakmarrjeje¹⁶³. Nuk ka asnjë mënyrë për të verifikuar shifrat e sakta, por është e dukshme që dënimet e ashpra për autorët e gjakmarrjeve dhe reputacioni i egër i regjimit të Hoxhës përsa i përket zbatimit të ligjit, mund të kenë bërë që njerëzit të zgjidhnin rrugën jo ligjore të hakmarrjes (vetëgjyqësinë) shumë më rrallë se zakonisht.

153 “Adoleshentët e armatosur kërcënojnë të vrasin pronarin e klubit të natës”, Çështjet e Krimit dhe Korrupsionit në Shqipëri, 29 janar–4 shkurt 2005. Burimi: Shekulli, 4 shkurt 2005; “Katër të rinj nga rrethi i Pukës arrestohen për vrasje të mbetur në tentativë të pronarëve të lokalit në Tiranë”, Çështjet e Krimit dhe Korrupsionit në Shqipëri, 8–14 janar 2005. Burimi: Shekulli, 27 janar 2005

154 “Dy vjet heqje lirie për njeriun e armatosur që kërcënoi policinë”, Çështjet e Krimit dhe Korrupsionit në Shqipëri, 5–11 mars 2005. Burimi: Shekulli, (versioni elektronik) 5 mars 2005

155 “Polici arrestohet nga kolegët e tij për përdorim të armës së tij të shërbimit”, Çështjet e Krimit dhe Korrupsionit në Shqipëri, 8–14 janar 2005. Burimi: Shekulli, (versioni elektronik), 12 janar 2005.

156 Intervistë, Hajdani, 14 maj 2005.

157 Kanuni ka qeverisur shumë aspekte të marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore; në veçanti ato të gjinive dhe pronës, në të gjithë Shqipërinë qysh në shekullin e pesëmbëdhjetë. Gjakmarrja konsiderohet si një nga elementët kryesorë të Kanunit, versioni më i përhapur i të cilit i atribuohet Lekë Dukagjinit (1410–1481). P.sh. shiko: T. Çobani, “Lekë Dukagjini dhe Kanuni i tij” faqja në Internet e Komitetit për Pajtimin Mbarëkombëtar, <<http://www.pajtimi.com/faqebrenda.php?newsID=30&lang=eng>>, 17 maj 2005.

158 Op cit Lawson dhe Saltmarshe, fq. 136–9; op cit Saltmarshe, fq. 190–3. *Mbi portretizimin e gjakmarrjes nga letërsia në Shqipërinë e Veriut, I. Kadare, Prilli i Thyer*, (Vintage, 2003).

159 Sipas Komitetit për Pajtimin Kombëtar, gjakmarrjet vazhdojnë të krijojnë probleme për familjet që jetojnë në Berat, Burrel, Elbasan, Fier, Krutë, Shkodër, Tropojë dhe Vlorë. Burimi: Faqja në Internet e Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar, <www.pajtimi.com>, 17 maj 2005.

160 Krahaso A. Khaakee, N. Florquin, “Kosova dhe armët: Një vlerësim kufizues i armëve të vogla dhe armatimeve të lehta në Kosovë, (Gjenevë, Studim për armët e vogla/PNUD, qershor 2003), fq. 31.

161 Op cit Biberaj; op cit Blumi; op cit Doll; op cit Lawson dhe Saltmarshe; op cit Saltmarshe.

162 Arie S, “Gjakmarrja e zë në kurth Shqipërinë në të shkuarën: mijëra vetë detyrohen të strehohen ndërkohë që kodi mesjetar vë në shënjestër baballarët dhe djemtë e tyre”, *The Observer*, 21 shtator 2003.

163 Op cit Biberaj; op cit Blumi; op cit Doll; op cit Lawson dhe Saltmarshe; op cit Saltmarshe

Një numër studiuesish kanë thënë që me mbarimin e sundimit komunist, shteti shqiptar e kishte gjithmonë e më të pamundur të kontrollonte sigurinë publike dhe atë private. Praktikën e korrupsionit në zbatimin e ligjit dhe sistemin ligjor bënë që çdo ditë e më shumë shqiptarët ta merrnin ligjin vetë në dorë, në bazë të të drejtës zakonore që rridhte nga Kanuni¹⁶⁴, kështu që gjatë periudhës 1992–1994 numri i vrasjeve për motive gjakmarrjeje u katërfishua¹⁶⁵.

Tabela 5: Numri i vrasjeve të regjistruara dhe vrasjeve për motive gjakmarrjeje në Shqipëri gjatë viteve 1997–2004.¹⁶⁶

Viti	Totali i vrasjeve të regjistruara	Vrasje për motive gjakmarrjeje	Vrasje për motive gjakmarrjeje (%)
1998	573	45	7.8
1999	496	41	8.2
2000	275	18	6.5
2001	208	32	15.4
2002	179	13	7.2
2003	144	12	8.3
2004	119	10	11.9

Tabela e mësipërme tregon një rënie të vazhdueshme si të numrit të përgjithshëm të vrasjeve ashtu edhe të atij të vrasjeve për motive gjakmarrjeje ndërmjet viteve 1998 dhe 2004. ndërkohë, tabela e mëposhtme tregon që, me përjashtim të viti 2004, përqindja e vrasjeve të regjistruara që kanë lidhje me gjakmarrjen qysh nga viti 1998 në Shkodër është shumë më e lartë se mesatarja kombëtare shqiptare. Edhe pse ky numër duket se është në rënie, në Drejtorinë e Policisë së Shkodrës, në fillim të vitit 2005, u krijua një njësi speciale për lufën kundër vrasjeve për motive gjakmarrjeje në këtë rajon.

Tabela 6: Numri i vrasjeve të regjistruara dhe vrasjeve për motive gjakmarrjeje në Shkodër gjatë viteve 1998–2004.¹⁶⁷

Year	Totali i vrasjeve të regjistruara	Vrasje për motive gjakmarrjeje	Vrasje për motive gjakmarrjeje (%)	% e vrasjeve për motive gjakmarrjeje të kryera në Shkodër ¹⁶⁸
1998 ¹⁶⁹	76	32	42.1	71
1999	82	42	51.2	102 ¹⁷⁰
2000	53	20	37.7	111
2001	45	13	28.8	40.6
2002	28	9	32.1	69.2
2003	22	8	36.4	66.7
2004	17	1	5.8	10

Institucioni i gjakmarrjes lejon vrasjen e çdonjërit prej anëtarëve meshkuj të rritur të familjes së zgjeruar të autorit të dyshuar të vrasjes, të cilët bëhen shënjestra legjitime për qëllime “kompensimi-(dëmshpërblimi)”. Kjo, sipas raportit, ka sjellë si rezultat që 1,270 burra kanë lënë Shqipërinë nga frika e vrasjes për motive gjakmarrjeje, dhe 2,500 familje të cilat janë përfshirë në gjakmarrje që në fillim të viteve 90.¹⁷¹ Sipas shifrave të

¹⁶⁴ Op cit Biberaj, fq 16 dhe 201; op cit Lawson and Saltmarshe, fq.. 136–9; op cit Saltmarshe, fq. 190–3.

¹⁶⁵ Op cit Biberaj, fq. 202.

¹⁶⁶ Op cit MRP, fq. 73 dhe 74.

¹⁶⁷ Intervistë, zyrtar I MRP, 15 maj 2005.

¹⁶⁸ Mospërputhja mes shifrave për Shkodrën dhe ato për Shqipërinë në shkallë kombëtare që ka bërë që më shumë se 100 përqind të vrasjeve për motive gjakmarrjeje në Shqipëri të jenë kryer në Shkodër në vitin 1999 dhe 2000, edhe një herë tjetër thekson problemet që kanë të bëjnë me saktësinë e shifrave të krimeve në Shqipëri.

¹⁶⁹ Të dhënat për këtë vit nuk janë shumë të sakta dhe ndoshta me mungesa sepse shumë nga dosjet e këtij viti u dogjën apo u zhdukën gjatë trazirave të vitit 1998.

¹⁷⁰ Fakti që kjo tabelë tregon që 102 përqind e gjakmarrjeve u regjistruan në Shkodër në vitin 1999 dhe 111 përqind e tyre në vitin 2000, ndodh për arsye se numri i vrasjeve për motive gjakmarrjeje të raportuara në Shkodër në vitin 1999 ishte një më shumë se numri total kombëtar i tyre në vitin 1999 dhe dy më shumë në vitin 2000. Mendohet që ky është rezultat i mangësisë së raportimit në Shqipëri mes rajoneve dhe qendrës.

¹⁷¹ Op cit Arie; Burimi: Faqja në Internet e Komitetit për Pajtimin Mbarëkombëtar, <www.pajtimi.com>, 17 maj 2005.

dhëna nga Komiteti për Pajtimin Kombëtar, në vitin 2001, 1,376 familje jetonin me frikën e gjakmarrjes në 746 fshatra dhe 17 qytete të Shqipërisë.

Tabela 7: Shpërndarja e familjeve të përfshira në gjakmarrje (viti 2001)¹⁷²

Zona	Familjet e përfshira në gjakmarrje	Fëmijët e prekur (1–18 vjeçarë)	Fëmijët e prekur (1–10 vjeçarë)	Fëmijët e prekur (11–18 vjeçarë)
Berat	62	26	11	15
Bulqiza	17	17	6	11
Burrel	48	47	15	32
Durrës	98	56	26	30
Elbasan	29	27	12	15
Fier	49	21	8	13
Gjirokastër	9	7	1	6
Has	28	44	18	26
Korçe	15	9	6	3
Kruja	11	13	3	10
Kukës	49	44	17	26
Kurbin	12	10	4	6
Lezha	18	11	2	9
Librazhd	4	6	3	3
Lushnje	33	34	10	24
M.madhe	67	53	24	29
Pogradec	6	4	0	4
Puka	13	0	0	0
Shkodër	460	108	51	57
Tepelene	16	20	10	10
Tirana	144	68	22	46
Tropoje	81	46	15	31
Vlorë	111	40	18	22
Totali	1,376	711	282	429

Një numër OJF-sh¹⁷³ deklarohet të kene punuar si ndërmjetës për të reduktuar numrin e familjeve që jetojnë nën kërcënimin e vrasjes për motive gjakmarrjeje. Në sajë të ndihmës së tyre, numri i familjeve të përfshira në gjakmarrje u reduktua nga 724 në vitin 2003, me vetëm 160 fëmijë të pamundur për të ndjekur shkollën për shkak të gjakmarrjes.¹⁷⁴ Veçanërisht në Shkodër, si tregohet në tabelën më poshtë, policia ka identifikuar 320 familje të cilat aktualisht janë ngujuar në shtëpitë e tyre për shkak të gjakmarrjes.

Tabela 8: Familjet e përfshira në gjakmarrje në Shkodër në qershor të vitit 2005¹⁷⁵

Zona	Familjet në gjak	Familjet "e ngujuara"	Njerëzit "e ngujuar"	Fëmijët "e ngujuar"
Shkodër	215	83	178	–
Puka	55	3	8	–
Malesi e madhe	50	23	62	–
Totali	320	109	248	34

Disa nga OJQ-të e përfshira në ndërmjetësimin e gjakmarrjeve janë kritikuar sepse u kanë kërkuar palëve të përfshira në gjakmarrje para për të kryer ndërmjetësimin.¹⁷⁶ Në raste të tjera, paqja është ndërmjetësuar, por policia pastaj e ka ndaluar të dyshuarin e

¹⁷² Burimi: Faqja në Internet e Komitetit për Pajtimin Mbarëkombëtar, <www.pajtimi.com>, 17 maj 2005.

¹⁷³ Lista përfshin: Shoqatën e Nënave me Jetimë(Pukë); Shoqatën e Misionarëve të Paqes(Shkodër); Shoqata BESA(Pukë); Fondacioni Lidhja e Misionarëve të Paqes(Shkodër);Fondacioni Paqe dhe Drejtësi(Kisha Katolike në Shkodër);Fondacioni për Zgjidhjen e Konflikteve(Tiranë);Misioni për Pajtimin Mbarëkombëtar(Shkodër); dhe Misionin e Pajtimin Nënë Tereza(Shkodër).

¹⁷⁴ Op cit Arie; op cit Lawson dhe Saltmarshe; op cit Saltmarshe.

¹⁷⁵ Burimi:Ministria e Rendit Publik

¹⁷⁶ Intervistë, zyrtar I MRP, 15 Maj 2005.

përfshirë në gjakmarrje. Në këto raste, është raportuar që ndërmjetësit e OJQ-ve janë përpjekur të shpjegojnë që ndalimi nuk është i nevojshëm sepse tashmë viktimat ka pranuar “ta falë gjakun”, dhe kështu që në gjykatë viktimat nuk kanë madje as bashkëpunuar me akuzën. Prandaj, mund të argumentohet që po funksionojnë struktura paralele “ligjore” të cilat pengojnë përpjekjet e shtetit kur ai përpiqet të kërkojë drejtësi për palën e dëmtuar.

Në vitin 2001, u bënë disa amendamente në Kodin Penal të cilat në mënyrë eksplicite kanë të bëjnë me gjakmarrjen:

- Neni 78/2 parashikon që vrasësit për motive gjakmarrjeje duhet të dënohen minimalisht me 20 vjet burgim dhe maksimalisht me burgim të përjetshëm;
- Neni 83/a parashikon që personat që kërcënojnë njerëzit dhe këmbëngulin që ata të ngujohen në shtëpitë e tyre apo që do të vriten për shkak të gjakmarrjes, mund të burgosen deri në tre vjet.

Sipas shefit të departamentit të krimeve në Shkodër, kohët e fundit ka patur disa raste në të cilat, ndërmjetësuesit e moshuar, të cilët janë dërguar nga familjet e viktimave të gjakmarrjes për të njoftuar familjen e autorit të krimit që të ngujohen, janë ndaluar nga policia.¹⁷⁷ Ata gjithashtu kanë hetuar një numër të dyshuara për gjakmarrje në Shkodër në vitin 2005, edhe pse i njëjti burim thekson që gjykatat në raste të tilla tregohen mjaft tolerante. Ndërkohë që sistemi shtetëror i drejtësisë vazhdon të përdorë drejtësinë në mënyrë joefikase, vrasjet për motive gjakmarrjeje nuk ka të ngjarë të zhduken.

2.4.3 Perceptimet për korrupsionin dhe krimin e organizuar

Transparency International e ka përfshirë Shqipërinë në Indeksin e saj të Perceptimeve për Korrupsionin (IPK) që në vitin 2002. Që prej kësaj date, Shqipëria në mënyrë të vazhdueshme ka pasur një normë të IPK prej 2.5.¹⁷⁸ Sidoqoftë, meqë më shumë vende i janë shtuar IPK, Shqipëria ka humbur disa vende në renditje. Kështu, në vitin 2002, ajo ishte në vendin e 81-të, por deri në vitin 2004 ajo ishte në të 108-in. Kjo mund të krahasohet me Maqedoninë dhe Serbi – Malin e Zi, të cilët ishin në vendin e 106-të në vitin 2003 kur Shqipëria ishte në të 92-in. Në vitin 2004, Maqedonia dhe Serbi-Mali i Zi, ndodheshin në vendin e 97-të me një rezultat prej 2.7 deri në 2.3. Duket sikur perceptimet për korrupsionin mbeten të qëndrueshme në Shqipëri, ndërkohë që ato po pësojnë rënie në vendet fqinje.

Gjatë sondazhit të kryer në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, korrupsioni ishte shqetësimi i dytë më kryesor i elektoratit, dhe krimi i organizuar renditej i gjashti.¹⁷⁹ Sondazhi, gjithashtu vuri në dukje se tre institucionet më të besueshme në Shqipëri ishin organizatat ndërkombëtare të BE-së, NATO-s dhe OSBE-së.¹⁸⁰ Media zinte vendin e katërt, e ndjekur nga Bashkia në vendin e pestë ku 47.2 përqind e pjesëmarrësve shprehnin besimin e tyre për këtë institucion, i ndjekur nga institucioni i Presidentit me 46.2 përqind dhe më pas Parlamenti me 46,1 përqind. Qeveria besohet nga një e treta e pjesëmarrësve, prokuroria nga 29 përqind e tyre dhe gjykatat me 25.7 përqind renditeshin të fundit në sondazh.

Shumë komentues shqiptarë dhe ndërkombëtarë mendojnë që lufta kundër krimit të organizuar duhet të jetë një ndër shqetësimet kryesore të Qeverisë, për shkak të ndikimit të saj negativ në shtetin e së drejtës dhe sistemin e drejtësisë. Sidoqoftë, pjesëmarrësit e fokus grupit, nuk e bënë këtë lidhje të drejtpërdrejtë. Ata u ankuan që ata nuk e perceptonin drejtësinë se po funksiononte sepse kriminelët nuk kapeshin

¹⁷⁷ Intervistë, zyrtar I MD 15 maj 2005.

¹⁷⁸ Faqja e Internetit e Transparency International për Indeksin e Perceptimit për Korrupsionin <<http://www.transparency.org>>, 6 qershor 2005. IPK shqiptar bazohet në vlerësimet e dhëna nga: Studimi mbi Performancën e Ndërmarrjeve në Mjedisin e Biznesit, Shtëpia e Lirisë, një bankë për zhvillimin multinacional, Studimi për Mjedisin e Biznesit Botëror të Bankës Botërore, Qendra e Kërkimeve të Tregjeve Botërore.

¹⁷⁹ Zgjedhjet 2005 Sondazhi mbi Opininionin Publik: Vështrim I Përgjithshëm mbi Rezultatet Kryesore (Mjaft dhe Gallup International, Tiranë, 1 qershor 2005), fq. 7. Shqetësimi kryesor i pjesëmarrësve ishte papunësia.

¹⁸⁰ Po aty, fq.21.

apo liroheshin nga gjykatat. Ekziston mendimi që korrupsioni e kufizon më tepër mundësinë e shtetit për të përmbushur zbatimin e ligjit dhe të veprimtarisë së drejtësisë. Përsëri, kur u pyetën nëse krimi i organizuar i prekte ata, të intervistuarit u përgjigjën:

– *Krimi i organizuar nuk më prek mua, aspak.*

– *Ai nuk do të më prekë për sa kohë që unë shoh punën time, nëse unë i shkel në kallo ndonjë personi tjetër, atëherë po... unë ja kam frikën më shumë krimeve të vogla idiote, si p.sh një adoleshent që vjedh makinën time, unë e kap atë, ndoshta e rrah, familja e tij më vret mua dhe gjëra të tjera si këto. Por krimi të cilit ja kam më shumë frikën është ai politik. U vra dikush ditën e zgjedhjeve vetëm për shkak të bindjeve të tij politike. Kjo është ajo që kam frikë. Unë s'ua kam frikën atyre që shesin drogë. Sepse unë nuk merrem me drogë.*

Fokus Grupi, Tiranë, Mashkull, gusht 2005.

2.4.4 Perceptimet për Policinë

Një nga rezultatet më pozitive të sondazhit të bërë në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, të cituara më sipër, ishte që 43 përqind e pjesëmarrësve shprehën besimin e tyre tek policia, një shifër që i habiti organizuesit e sondazhit.¹⁸¹ Kjo rritje e nivelit të besimit, mund të ketë ndodhur si pasojë e faktit që gjatë vitit 2004 drejtuesi i policisë, Bajram Ibraj, u pa të merrte masa të ashpra ndaj korrupsionit në rradhët e policisë duke larguar nga puna 304 oficerë dhe duke ndaluar 52 prej tyre me akuza për korrupsion.¹⁸² Sidoqoftë, janë bërë rregullisht deklarata në lidhje me korrupsionin e vazhdueshëm brenda akademisë së policisë, policisë, forcave të kufirit dhe doganës, të cilat sugjerojnë që mbetet ende shumë punë për tu bërë para se korrupsioni të mos konsiderohet më si një problem serioz për zbatimin efektiv të ligjit. P.sh. Në një studim mbarëkombëtar që u bë në vitin 2004, nga Qendra për Studimet Rurale (Tiranë) në kuadrin e Mbështetjes që UNDP i jep Reformës në Sektorin e Sigurisë, në lidhje me punën e policisë, vetëm 35 përqind e pjesëmarrësve e shikonin punën e bërë nga policia me respekt të madh.¹⁸³ 22 përqind e tyre thanë që ata kishin pak respekt për policinë, ndërsa 42 përqind e tyre deklaruan që respekti i tyre varionte. Sidoqoftë, raporti sugjeron që ndërkohë që gjinia, mosha apo arsimimi nuk ndikojnë në vlerësimin e punës së policisë, me 39 përqind të tyre që jepnin një vlerësim pozitiv dhe 45 përqind që thanë që ishte të paktën e pranueshme, u vunë re ndryshime domethënëse rajonale, kur ata u pyetën nëse ata besonin se do të merrnin një "rezultat të drejtë" nga policia nëse ata do ti kërkonin asaj të kryente detyrën.¹⁸⁴ Në intervistat dhe studimin tonë, skuadra e kërkimit gjithashtu zbuloi që qytetarët shqiptarë nuk ishin plotësisht të kënaqur me mbrojtjen që institucionet shtetërore që sigurojnë zbatimin e ligjit, i ofrojnë njerëzve dhe pronës së tyre, ashtu si u shpreh një nga të intervistuarit e grupit të fokusit:

[Fatkeqësisht] asnjë nuk mendon mirë për policinë këtu. Për shembull, kur unë shoh një polic, unë nuk ndjej respekt për të se nuk e shoh atë si dikë që më mbron. Unë nuk e shoh atë si një njeri të ndershëm, i cili përpiqet të vëndosë drejtësinë duke respektuar ligjin. Kështu, nëse unë dua të kryej një krim, apo të shkel rregullat, unë nuk kam frikë prej tij. Kjo figurë nuk ekziston në Shqipëri. Mund të ketë edhe policë të ndershëm, por shumica e tyre janë të korruptuar, ata mendojnë vetëm për paratë, në çdo gjë që bëjnë ata mendojnë si e si të nxjerrin ca para për veten e tyre, ja pse nuk e shoh policin si një njeri që respekton ligjin. Unë thjesht e shoh atë si një njeri që bën një punë të caktuar.

Fokus Grupi, Shkodër, Femër, gusht 2005.

¹⁸¹ Intervistë, përfaqësues i OJQ-së, 21 korrik 2005; Zgjedhjet 2005 Sondazhi mbi Opininionin Publik: Vështrim I Përgjithshëm mbi Rezultatet Kryesore (Mjaft dhe Gallup International, Tiranë, 1 qershor 2005)

¹⁸² "Rreth 304 policë largohen nga rradhët e policisë në vitin 2004", Çështjet e Krimin dhe Korrupsionit në Shqipëri, 8–14 janar 2005. Burimi: Zëri i Popullit, 12 janar 2005.

¹⁸³ D. J. Kenney, Perceptimet Publike për Policinë në Shqipëri: Studim Mbarëkombëtar mbi Qytetarët dhe Policinë (Universiteti i Nju Jorkut dhe PNUD SSSR, 2004) fq. 18.

¹⁸⁴ Sipas studimit të Kenney, pjesëmarrësit nga Berati (73 përqind), Fieri (75 përqind), dhe Tirana (62 përqind), ishin ndërmjet rajoneve me besim më të madh në punën e policisë, ndërsa në Dibër (27 përqind), Durrës (28 përqind) dhe Kukës (34 përqind), pjesëmarrësit kishin më pak besim. Po aty, fq. 14–15.

Përgjigje të ngjashme në të gjitha grupet e tjera të fokusit të përbëra vetëm nga femra, të realizuara në vitin 2005, përputhen me rezultatet e studimit Perceptimet Publike për Policinë në Shqipëri, gjë që sugjeron faktin që një përqindje më e lartë e grave kanë frikë nga policia më shumë se burrat, ndërkohë që një përqindje më e ulët e grave kanë një respekt në rritje apo më të madh, ose besim tek policia.¹⁸⁵ Meqë 34.4 përqind e pjesëmarrësve mendojnë që është e pranueshme të mbash një armë zjarri “kur ligji nuk zbatohet”, mungesa e besimit tek policia, është një pengesë e qartë për të patur një kontroll më të madh në armëmbajtjen pa leje. Incidentet e vërtetuara të korrupsionit dhe keqfunksionimit, (duke përfshirë ato në lidhje me trafikimin e AVL), si edhe thashethemet e vazhdueshme, gjithashtu e dëmtojnë imazhin e autoriteteve.¹⁸⁶

2.5 Incidentet e shkaktuara nga AVL në raportet e medias

Ekipi i studimit bëri një analizë të frekuencës me të cilën incidentet e shkaktuara nga armët e zjarrit ishin pasqyruar në gazetën e përditshme shqiptare Shekulli gjatë viteve 2002, 2003, 2004 dhe 5 muajve të parë të vitit 2005. Rezultatet e kësaj analize mund ti gjeni në tabelat e mëposhtme:

Tabela 9: Frekuenca e incidenteve të shkaktuara nga armët e zjarrit të pasqyruara në gazetën Shekulli gjatë periudhës 2002–2004.

2002	Vrasjet	Vrasjet në tentativë	Plagosjet	Vetvrasjet	Kërcënime me armë	Marrjet peng	Grabitjet	Armëmbajtjet pa leje	Sulmet me armë
Janar	2	2	–	1	–	–	–	1	1
Shkurt	2	–	–	–	–	–	–	–	1
Mars	10	1	–	2	–	–	–	–	1
Prill	11	–	–	–	–	1	–	1	–
Maj	7	1	–	–	–	–	–	–	–
Qershor	1	–	1	1	–	–	–	1	–
Korrik	2	3	–	1	–	–	1	–	–
Gusht	8	1	–	–	–	–	–	–	–
Shtator	2	1	3	3	5	–	2	2	1
Tetor	5	1	–	1	–	1	–	2	2
Nëntor	7	1	7	2	2	–	1	4	2
Dhjetor	6	–	1	2	4	1	–	–	1
Totali	64	11	12	13	11	3	4	11	9
	138								

2003	Vrasjet	Vrasjet në tentativë	Plagosjet	Vetvrasjet	Kërcënime me armë	Marrjet peng	Grabitjet	Armëmbajtjet pa leje	Sulmet me armë
Janar	11	–	7	3	1	–	1	2	3
Shkurt	3	2	–	4	–	–	–	1	–
Mars	4	–	–	3	–	–	–	–	–
Prill	4	3	–	1	–	1	–	2	1
Maj	5	1	1	2	–	–	1	–	1
Qershor	7	2	1	1	–	–	–	2	–
Korrik	6	4	2	3	1	–	2	2	2
Gusht	16	2	6	–	1	2	2	1	4
Shtator	2	4	2	–	–	–	–	1	2
Tetor	9	–	2	3	1	–	–	–	–
Nëntor	7	3	1	2	3	–	–	3	–
Dhjetor	5	–	1	–	–	–	1	–	–
Totali	79	23	23	22	7	3	7	14	13
	191								

¹⁸⁵ Op cit, Kenney, fq.19.

¹⁸⁶ Sipas një informatori të rëndësishëm të MRP, në të shkuarën ka patur raste ku oficerët e policisë janë kapur duke u marrë me trafikimin e armëve. Intervistë, zyrtar i MRP, 26 prill 2005.

2004	Vrasjet	Vrasjet në tentativë	Plagosjet	Vetvrasjet	Kërcënime me armë	Marrjet peng	Grabitjet	Armëmbajtjet pa leje
Janar	5	3	–	2	1	–	–	1
Shkurt	6	2	4	1	–	–	–	
Mars	9	–	–	–	1	–	–	
Prill	7	4	1	1	2	–	–	1
Maj	4	2	–	4	2	–	–	
Qershor	11	2	–	3	1	–	–	1
Korrik	1	5	1	3	–	1	–	1
Gusht	11	4	1	1	–	–	–	
Shtator	5	2	–	3	–	–	–	1
Tetor	6	–	–	2	–	–	–	
Nëntor	4	1	–	2	–	–	–	1
Dhjetor	–	3	–	–	4	–	–	
Total	69	28	7	22	11	1		
138								

2005	Vrasjet	Vrasjet në tentativë	Plagosjet	Vetvrasjet	Kërcënime me armë	Marrjet peng	Grabitjet	Armëmbajtjet pa leje
Janar	3	2	–	1	1	–	–	
Shkurt	2	5	–	3	1	1	3	
Mars	2	2	–	3	–	–	–	
Prill	3	–	1	4	–	–	–	2
Maj	2	1	–	1	–	–	–	
Total	12	10	1	12	2	1	3	
41								

deri në 15 Maj

Nga këto tabela del se shumica e artikujve rreth armëve të zjarrit në gazetën Shekulli bënin fjalë për vrasje dhe vrasje të mbetura në tentativë. Ka të ngjarë që kjo të reflektojë më shumë interesin e publikut për ngjarje të tilla sensacionale sesa frekuencën e tyre më të madhe në vetvete. Numri i artikujve në lidhje me plagosjet ndryshonte, ndërkohë numri i artikujve që i referoheshin vetvrasjeve pothuajse u dyfishua nga viti 2002 deri në vitin 2003. Ndërkohë që në gusht, shumica e historive ishin për vrasjet gjatë viteve 2003–04, në vitin 2002 artikujt më të shumtë për vrasjet u botuan në prill dhe maj. Nuk ka shenja të një modeli të dallueshëm sezonal përsa i përket pasqyrimin të tentativave për vrasje, plagosjeve apo vetvrasjeve në gazetën Shekulli gjatë këtyre viteve të marra si model.

Pistoletat TT, automatikët Kallashnikovë, pushkët automatike dhe ato të gjuetisë janë armët kryesore të zjarrit që përmenden në këto artikuj, edhe pse në shumë artikuj nuk thuhet hapur lloji i armës së përdorur. Normalisht thuhet që arma e përdorur është e paregjistruar, dhe përgjithësisht supozohet se është grabitur në vitin 1997. Sidoqoftë, në një numër vrasjesh me profil më të lartë në vitin 2003 u përdorën armë më të sofistikuar. P.sh. në vrasjen e një biznesmeni në Tiranë në vitin 2003, u përdor një bombë e komanduar në distancë nga një telefon celular. Eksplozivi nuk përdoret shumë për vrasje, edhe pse ekziston tendenca par ta përmendur gjatë paqyrimin të incidenteve, shpesh duke përfshirë edhe fëmijët.

Shumica e incidenteve të shkaktuara nga armët e zjarrit ndodhin në zonat rurale apo në rrethinat e qyteteve. Shumica e vrasjeve të pasqyruara në Shekulli u kryen ndaj anëtarëve të të njëjtës familje. Mosmarrëveshjet për pronat, xhelozia, alkooli, dhe depresioni ishin ndër arsytet më shumë të cituara për përdorimin e armëve të zjarrit. Pothuajse në të gjitha këto raste, arma e zjarrit- zakonisht një pistoletë- ishte afër dorës. Mosmarrëveshjet për pronat gjithashtu përmenden si shkaku kryesor i vrasjeve dhe plagosjeve ndërmjet njerëzve që nuk janë anëtarë të të njëjtës familje, edhe pse në shtyp janë pasqyruar gjithashtu raste të hakmarrjeve të krimit të organizuar apo gjakmarrjes.

Një ndër ndryshimet më të dukshme është që grabitjet me armë nuk i dominojnë më titujt e faqeve të para të gazetave, ku pjesa më e madhe e kolonave të tyre zihet nga vetvrasjet. Fakti që gjatë viteve 2003–2004 u pasqyruan 22 artikuj për vetvrasjet, mendohet të jetë shenjë e interesit më të madh që ka media për këtë fenomen, ku vetëm gjatë pesë muajve të parë të vitit 2005 pati 12 artikuj për këtë çështje. Rastet më të fundit të një profili më të lartë përsa i përket vetvrasjeve, kanë patur të bëjnë me të rinjtë e moshës 10–14 vjeçare.

Historitë rreth trafikimit të armëve të zjarrit janë pakësuar në numër ëysh nga viti 2002, por artikujt e trafikuar mesa duket kanë cilësi më të mirë. Kështu, kapjet e armëve të trafikuar të cilat nuk janë raportuar, kanë të bëjnë me raketa dhe bomba me detonator me telefon celular, sesa AK-27 dhe pushkë jo-automatike. Sidoqoftë, këta artikuj, prirën drejt portretizimit të trafikut si një seri ngjarjesh të izoluar, dhe jo si pjesë përbërëse e një veprimtarie të bashkërenduar dhe të rregullt në një shkallë më të madhe.